

CEL Kosova dhe Departamenti i Psikologjisë

EKSPERIENCAT E TË QENIT JO-BINARË NË KOSOVË: NJË STUDIM KUALITATIV

Hulumtuese: Lea Rrahmani & Rita Bega
MENTORE: Prof. Dr. Kaltrina Kelmendi



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

MENTORE: PROF. DR. KALTRINA KELMENDI

STUDENTE: LEA RRAHMANI & RITA BEGA

Shtator, 2026

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga SIDA – Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar dhe u realizua në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerit dhe donatorit.

Abstrakti

Ky hulumtim eksploron eksperiencat që kanë personat që identifikohen si jo-binarë në Kosovë. Literatura ekzistuese për kontekstin kosovar është e cekët, prandaj, studimi gjithashtu synon të plotësojë këtë mungesë. Studimi është kualitiv, dhe të dhënat janë mbledhur duke përdorur intervista gjysmë të strukturuar. Pjesëmarrës të studimit ishin tre persona që identifikohen si persona jo-binarë, të rekrutuar dhe intervistuar nga autoret e studimit. Nga kjo analizë, u nxorrën gjashtë tema, të cilat ishin: (1) Mungesa e terminologjisë: “Mdokët që kur foli shqip duhët me ba matematikë n’krye”, (2) Rëndësia e një rrethi social me persona të besuar, (3) Qasja në profesionistë të besuar të shëndetit mendor: Lista e terapistëve nga CEL Kosova, (4) Ekzistenca e hapësirave për persona LGBTI+ dhe rëndësia e tyre, (5) Mungesa e mbështetjes institucionale për personat jo-binarë, dhe (6) Rekomandime për përmirësimin e mbështetjes ndaj personave jo-binarë. Të gjitha këto gjetje përkojnë me gjetje nga studime me tematikë të ngjashme me studimin aktual.

Fjalë kyçe: Jo-binarë, Kosovë, eksperiencat, identiteti gjinor, gjuha dhe terminologjia.

Hyrje

Gjinia është përshkruar nga studiues të ndryshëm si ndjesia e brendshme e një personi për "gendered self" dhe vendin në botë. Gjinia ndryshon nga tiparet fiziologjike seksuale dhe nuk përcaktohet nga organet gjenitale të jashtme. Përkundrazi, gjinia është një konstrukt i identitetit gjinor të një individi. Njerëzit cisgjnorë, ose jo-transgjnorë, janë individë identiteti gjinor i të cilëve përputhet me seksin që u është caktuar atyre në lindje. Njerëzit transgjnorë dhe me gjini të ndryshme janë ata që identifikojnë ose shprehin gjininë e tyre ndryshe nga gjinia e tyre e caktuar në lindje. Koncepti i gjinisë tashmë ka evoluar, gjinia tani shihet si një spektër, një material ose vazhdimësi e kufizuar, por jo e kufizuar në përcaktimet mashkull dhe femër. Njerëzit që nuk përshtaten në përkufizimin historik të gjinisë mund të përshkruhen si të larmishëm sipas gjinisë, fluid sipas gjinisë, krijues sipas gjinisë, jo-konformues sipas gjinisë dhe/ose jo-binarë (Bass, Gonzalez, Colip, Sharon & Conklin, 2018; Quintana & Pfaus, 2024).

Identiteti gjinor i personave jo-binarë qëndron jashtë kufijve të një dikotomie të rreptë mashkull-femër. Ai është i pavarur nga seksi biologjik (mashkull, femër ose interseksual) dhe orientimi seksual (heteroseksual, homoseksual, biseksual ose panseksual) i personit. Personat jo-binarë dhe transgjnorë konsiderohen minoritete gjinore, por mund të ketë dallime midis të dyjave (Liszewski, Peebles, Yeung & Arron, 2018). Jo të gjithë personat jo-binarë përdorin përemrat they/them/theirs, dhe as të gjithë personat që përdorin përemrat they/them/theirs identifikohen si jo-binarë. Për më tepër, përdorimi i përemrave binarë, ai dhe ajo, nuk është ekskluziv për individët cis, pasi individët trans dhe jo-binarë gjithashtu i përdorin ato. Neopëremrat në gjuhën e huaja, siç janë xe/xem/xyr dhe ze/hir/hirs, përdoren gjithashtu nga individët jo-cis (Dev et al., 2021).

Derisa shumë organizata po bëhen më tolerante dhe gjithëpërfshirëse ndaj identiteteve trans dhe jo-binarë, jo të gjitha vendet e punës i mbrojnë punonjësit e tyre që kanë këto identitete. Për më tepër, këta individë ende nuk marrin mbrojtje në nivel federal (Dray, Smith, Kostecki, Sabat & Thomson, 2020). Një raport i bërë nga International Labour Organization, tregon se edhe pse ka rritje të numrit të grave në vendin e punës, përfshirja e personave të komuniteteve LGBTI+ është ende e injoruar në masë të madhe nga shumë programe për diversitetin gjinor në vendin e punës (Maji, Yadav, & Gupta, 2024). Në aspektin ndërpersonal, individët trans dhe jo-binarë mund të përjetojnë intolerancë, refuzim dhe keqtrajtime të tjera të hapura dhe/ose delikate nga kolegët dhe mbikëqyrësit e tyre. Në të vërtetë, është treguar se 15–57% e personave transgjnorë dhe jo-binarë përjetojnë diskriminim në vendin e punës. Hulumtimet kanë treguar gjithashtu se individët trans dhe jo-binarë pëlqehen më pak se kolegët e tyre cisgjnorë. Pjesa më e madhe e reagimit ndaj tyre vjen nga klima e ashpër socio-politike në Shtetet e Bashkuara që vazhdon të patologjizojë dhe poshtërojë individët e këtyre komuniteteve. Punonjësit transgjnorë shihen si "më pak të pëlqyeshëm në krahasim me kolegët e tyre cisgjnorë". Personat jo-binarë që janë caktuar meshkuj në lindje mendohet se kanë performancë më të ulët në punë përmes perceptimeve të reduktuara të pëlqyeshmërisë në krahasim me burrat që u janë caktuar meshkuj në lindje (meshkujt cisgjnorë) (Dray, Smith, Kostecki, Sabat & Thomson, 2020).

Komunitetet transgjnore dhe jo-binare përballen me pabarazi të konsiderueshme shëndetësore, veçanërisht në aspektin e shëndetit mendor dhe rreziqeve që lidhen me HIV. Këto pabarazi i atribuohen pjesërisht faktorëve stresues të pakicave që rrjedhin nga stigmatizimi i shoqërisë ndaj moskonformitetit gjinor dhe barrierave socioekonomike përkatëse që prekin popullatat transgjnore. Gjetjet nga Sondazhi Kombëtar i Diskriminimit Transgjnor i vitit 2011

tregojnë më tej se individët queer dhe jo-binarë përballen me nivele edhe më të larta ngacmimi, sulmi seksual dhe diskriminimi në mjediset e kujdesit shëndetësor krahasuar me individët transgjinorë binarë. Të rinjtë queer dhe jo-binarë, në veçanti, përjetojnë nivele më të larta ngacmimi dhe sulmi seksual në shkollat fillore dhe të mesme, krahasuar me të rinjtë transgjinorë binarë. Ky sondazh zbuloi gjithashtu se 36% e individëve 'queer' dhe jo-binarë shtynë marrjen e kujdesit mjekësor për shkak të frikës nga trajtimi i pandjeshëm ose jokompetent krahasuar me 27% të bashkëmoshatarëve të tyre transgjinorë binarë (Lykens, LeBlanc & Bocktin, 2018).

Personat jo-binarë përballen me shkallë të lartë të problemeve mendore, shqetësimit psikologjik dhe diagnozave psikiatrike. Shëndeti mendor i personave jo-binarë mund të dëmtohet nga përvojat negative që lidhen me të qenit pakicë gjinore në shoqëri, me shkallë të larta diskriminimi, refuzimi dhe stigma të brendshme që secila prej tyre tregon se parashikon shqetësime të shëndetit mendor midis individëve të komuniteteve LGBTI+. Shumë persona jo-binarë që tregojnë prova të shqetësimit psikologjik nuk kanë akses në shërbime. Personat në këtë komunitet përjetojnë shkallë më të larta të diagnozave psikiatrike, shqetësimit psikologjik dhe vetëvrasjes sesa individët cis gjinorë. Personat jo-binarë që punojnë me një ofrues kujdesi shëndetësor që është gjithëpërfshirës ndaj komunitetit raportojnë nivele dukshëm më të ulëta të depresionit dhe vetëvrasjes krahasuar me ata që kërkojnë ndihmë nga një ofrues që nuk është specifikisht gjithëpërfshirës ndaj tij (Cronin, Pepping & Lyons, 2023).

Republika e Kosovës ka një kornizë ligjore që garanton të drejtat e personave LGBTI+, duke përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të mbrojtura nga diskriminimi në Kushtetutë dhe ligje të tjera. Megjithatë, ekziston një boshllëk midis ligjit dhe jetës së përditshme, duke përfshirë mungesën e zbatimit efektiv të legjislacionit dhe mosbesimin institucional. Projektligji për Gjendjen Civile, i cili do të krijonte një procedurë administrative për ndryshimin e gjinisë, mbetet i bllokuar, duke i lënë personat trans dhe jo-binarë të varur nga procese gjyqësore të gjata dhe të kushtueshme. Në arsim, Ligji për Arsimin Parauniversitar ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual, por nuk ofron masa specifike dhe konkrete për të mbështetur personat LGBTI+. Ndërsa në punësim, Ligji i Punës dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi përfshijnë orientimin seksual si bazë të mbrojtur, por zbatimi mbetet i dobët dhe mungojnë politika proaktive për integrim. Për më tepër, të dhënat statistikore për personat LGBTI+ në arsim dhe punësim nuk mblidhen fare, duke frenuar bazën për krijimin e politikave efektive. Mungesa e strehimoreve të specializuara dhe mungesa e shërbimeve shëndetësore që afirmojnë gjininë e përkeqësojnë më tej cenueshmërinë e komunitetit (Rrasaj, 2025).

Pavarësisht literaturës në lidhje me eksperiencat e individëve jo-binarë në kontekst global, ekziston një boshllëk në hulumtime të realizuara në kontekstin kosovar. Madje, ky boshllëk është prezent edhe në ato të realizuara në shtetet e Ballkanit. Shumica e hulumtimeve deri më tani janë kryesisht në lidhje me eksperiencat e individëve jo-binarë në aspektin shëndetësor, e sidomos ato që janë realizuar në Britaninë e Madhe. Kjo bën që eksperiencat e individëve jo-binarë në fushat e tjera të jetës të jenë më pak të studiuara, dhe rrjedhimisht, të kuptohen më pak.

Metodologjia

MOSTRA

Në hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej tre pjesëmarrës, të cilët identifikohen si persona jo-binarë. Dy nga pjesëmarrësit vinin nga qyteti i Kaçanikut, dhe një pjesëmarrës tjetër vinte nga qyteti i Ferizajit, Kosovë. Ata ishin moshë të ndryshme, ku një prej pjesëmarrësve ishte në moshën 27 vjeçare, pjesëmarrësi tjetër ishte në moshën 19 vjeçare, pothuajse 20 vjeçare dhe pjesëmarrësi i fundit ishte në moshën 29 vjeçare. Para fillimit të intervistës, u pyet për termin që pjesëmarrësit përdorin për gjininë e tyre, ku të tre shprehën se përdorin termin “jo-binarë”. U pyet gjithashtu sa i përket terminologjisë që preferojnë të përdorin kur dikush i referohet, gjegjësisht “pronouns”. Njëri pjesëmarrës shprehu se në gjuhën shqipe përdor termet “ai/atij” ndërsa në gjuhën angleze “they/them”, pjesëmarrësi tjetër shprehu se në gjuhën shqipe përdor të gjitha variacionet e përemrave vetorë, ndërsa në gjuhën angleze “she/her/they/them” dhe pjesëmarrësi i fundit tregoi që në gjuhën angleze përdor “they/them”, ndërsa në gjuhën shqipe kta.

METODA KËRKIMORE/INSTRUMENTI

Në këtë hulumtim është përdorur metoda kualitative e studimit dhe si instrument është përdorur intervista e gjysmë strukturuar, pyetjet e të cilave u formuluan në bashkëpunim mes nesh dhe mentores sonë. Ashtu siç argumenton DeJonckheere & Vaughn (2019), një intervistë gjysmë e strukturuar është një metodë kërkimore cilësore që përdor një listë pyetjesh të hapura për t'u eksploruar, por i lejon intervistuesit të bëjë pyetje pasuese, të ndryshojë rendin e temave dhe të thellohet më shumë bazuar në përgjigjet e pjesëmarrësit. Pyetjet gjurmuese u formuluan gjatë bisedës me pjesëmarrësit, në bazë të bisedës dhe nevojës për to. Pyetjet e intervistës u fokusuan në aspekte të ndryshme, si aspekti familjar, social, organizativ, mjekësor, psikologjik dhe institucional.

PROCEDURA

Ky hulumtim kishte për qëllim të studioj përvojat e individëve jo-binarë në Kosovë. Intervistat u realizuan në ambientin e Fakultetit Filozofik, në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, më saktësisht në Institutin e Psikologjisë. Këto intervista u realizuan në një periudhë dy ditore, në muajin Maj. Para se të fillonin intervistat, pjesëmarrësit u informuan për qëllimin e hulumtimit, kohëzgjatjen dhe procesin e intervistës. Gjatë intervistës, u bë audio-inçizimi për arsye të lehtësimit të procesit të transkriptimit. Transkriptimi i tyre u përfundua në një periudhë prej 3 ditësh dhe realizimi i saj u bë në mënyrë manuale nga intervistuesit e secilës intervistë. Pasi që janë transkriptuar intervistat, për të analizuar intervistat dhe për të dalur me të dhëna cilësore, kemi përdorur analizën tematike. Analiza tematike është procesi i identifikimit të temave brenda të dhënave cilësore. Braun & Clarke (2017) sugjerojnë se është metoda e parë cilësore që duhet mësuar dhe që ofron aftësi thelbësore që do të jenë të dobishme për kryerjen e shumë llojeve të tjera të analizave.

ETIKA

Para fillimit të intervistave, të intervistuarit u informuan për qëllimin e hulumtimit dhe kohëzgjatjen e intervistës. Të intervistuarve iu garantua se pjesëmarrja është plotësisht vullnetare dhe se kanë të drejtën për të ndërprerë intervistën në çdo moment. Për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe anonimitetit të intervistuarve, u theksua se të dhënat nga intervista do të përdoreshin vetëm për qëllime të hulumtimit dhe nuk do të përdoreshin për ndonjë qëllim tjetër. Transkriptat e intervistave u ndanë vetëm mes autoreve të studimit dhe të gjitha informatat që mund të përdoren për identifikim u cenzoruan në rast të përdorimit.

DEKLARATË REFLEKSIVE

LR është studente e sapo diplomuar në nivelin bachelor në Departamentin e Psikologjisë, në Universitetin e Prishtinës, Kosovë. Interesimi i saj i veçantë për çështje që kanë të bëjnë më të drejtat e njeriut, dhe sidomos komunitetet LGBTI+ e kanë shtyrë atë që të bëjë këtë hulumtim.

RB është një studente e sapo diplomuar në bachelor, Departamentin e Psikologjisë, në Universitetin e Prishtinës, Kosovë. Interesi i saj për hulumtime kualitative e kanë bërë atë që të realizoj këtë hulumtim.

Rezultatet

1. MUNGESA E TERMINOLOGJISË: “MDOKËT QË KUR FOLI SHQIP DUHËT ME BA MATEMATIKË N’KRYE”

Një nga temat që u identifikua për këtë studim ishte mungesa e terminologjisë neutrale për gjini në gjuhën shqipe. Kjo u vërejt që në fillim të tre intervistave, ku të intervistuarit pyeten nëse mund të shprehen edhe në gjuhën angleze gjatë procesit. Fillimisht, të gjithë pjesëmarrësit shprehën se u njoftuan me konceptin e të qenit jo-binarë në gjuhën angleze, dhe në mungesë të fjalëve adekuate në gjuhën shqipe, vazhduan të përdorin terminologjinë në gjuhën angleze. Në pyetjet e hartuara që ishin në lidhje me gjuhën, terminologjinë, dhe strategjitë e përdorura për t’i zëvendësuar shprehjet në mungesë, të gjithë pjesëmarrësit cekën se preferojnë të vazhdojnë të shprehen në gjuhën angleze, për shkak të ekzistencës së përemrave dhe termeve që janë ekskluzivisht neutrale në gjini, gjë që nuk ekziston në gjuhën shqipe.

“Edhe m’pengon edhe mu fakti që nuk kem n’shqip fjalë, po meqenëse pe kuptojnë they/them, atëher është nifar zgjidhje, qaty për qaty është ni zgjidhje” – pjesëmarrësi 3 (P.3)

Por, sa i përket artikulimit të këtyre strategjive për në gjuhën shqipe, u observua se vërtet mungonte një konceptualizim në gjuhën shqipe, që në masë të madhe mund t’i atribuohet mungesës sistematike të terminologjisë. Kjo mungesë e terminologjisë u vërejt jo vetëm në aspektin e përemrave, por edhe në raste tjera konkrete, si p.sh.: Njëri pjesëmarrës shprehu se ai e ka pasur të vështirë të përcaktojë se si vëllau i tij t’i referohet, pasi gjuha shqipe nuk ka një fjalë asnjëse për vëlla/motër, siç gjendet në gjuhë tjera si gjuha angleze dhe ajo gjermane.

“Okej qysh um thotë vllau jem tani, se s’ka naj fjalë për vlla ose motër, ëëm, ama për shembull, gjermanisht që osht gjuhë me dy gjini gjithashtu, aty ka fjalë për qëta, edhe ... m’dokët që edhe shqip sigurt u kanë najher najnja ose diçka që mun mu kanë e përafërt.” – pjesëmarrësi 2 (P.2)

Të gjithë pjesëmarrësit shprehën edhe dëshirë për të krijuar shprehjet adekuate në gjuhën shqipe dhe të përshtatshme për kulturën e tyre. Për më tepër, pjesëmarrësit jo vetëm kanë shprehur dëshirë për krijimin e shprehjeve por njëkohësisht janë edhe duke bërë përpjekje për t’u kthyer gjithmonë e më shumë në gjuhën shqipe, dhe përdorimin e saj edhe në jetën e përditshme.

“Edhe qitash në vitet e fundit sidomos e kam gjetë duke e shpreh veten ma shumë me shqip. Edhe tu e shty veten mu shpreh shqip se shqiptar jam. I jemi është. Pse mos me bo një vend për veten edhe në shqip?” – pjesëmarrësi 1 (P.1)

Dhe gjithashtu, u shpreh nga të intervistuarit se ose janë në kërkim të fjalëve, ose janë të hapur ndaj krijimit të fjalëve të reja, në mënyrë që gjinia dhe identiteti i tyre të jetë më e dukshëm në komunitetin ku jetojnë.

2. RËNDËSIA E NJË RRETHI SOCIAL ME PERSONA TË BESUAR

Të tre pjesëmarrësit folën për rrethin e tyre shoqërorë, dhe rëndësinë që ata vendosin mbi këtë rreth. Njëri nga pjesëmarrësit shpreh se një nga aspektet pozitive të identitetit të tyre gjinorë është realisht në lidhje me pranimin që ata ndjejnë nga shoqëria e tyre.

“Po, e ndjej përkrahjen prej tyre maspari prej trajtimit që qysh më trajtojnë. Nuk m’trajtojnë si... më thanë më një mënyrë, si një alien. Ose diçka ma ndryshe. Më trajtojnë si njeri, nuk më trajtojnë..... Janë njerëzor me një fjalë. M’kqyrin, edhe qysh me thanë... [...] M’shikojnë, qysh me thanë, m’shohin.” – P.1

Pjesëmarrësi tjetër gjithashtu tregon për eksperiencën e tij me personat që ka rreth. Ai ndan eksperiencën nga një moshë më e re, ku një person, në retrospektivë, nuk e kishte pranuar mirë identitetin e pjesëmarrësit. Dhe më pas, këtë eksperiencë, e krahason me shoqërinë dhe personat që e rrethojnë tani, duke shprehur se pranimi dhe qasja e tyre është shumë më e mirë dhe duar-hapur. Gjithashtu është rasti i pjesëmarrësit tjetër, të cilët shprehin se qasja pozitive që kishin jo vetëm shoqëria e tyre, por edhe familja e tyre, ishin faktorë ndihmues që ata të ndihen të validuar në identitetin e tyre. Pra, nga këto kuptojmë se personat që janë pjesë e rrethit social të një personi që identifikohet si jo-binarë ka një ndikim të konsiderueshëm në ndjenjat dhe pranimin që dhe ata vetë kanë për veten e tyre.

3. QASJA NË PROFESIONISTË TË BESUAR TË SHËNDETIT MENDOR: LISTA E TERAPISTËVE NGA CEL KOSOVA

Një temë tjetër që u parashikua të trajtohet ishte qasja në dhe marrja e shërbimeve psikologjike. Përderisa njëri nga pjesëmarrësit shpreh se nuk kanë marrur asnjëherë ndihmë psikologjike nga një profesionist, ata shprehin se ndjehen të stepur për të marrë shërbime të tilla për shkak të përvojave negative që personat rreth tij kanë pasur. Por, duke thënë këtë, ata gjithashtu shprehin se kjo nuk i ka kthyer përfundimisht kundër marrjes së ndihmës profesionale. Ata përmendin listën e terapistëve të përpiluar nga CEL Kosova si diçka që i bën ata të konsiderojnë më seriozisht marrjen e shërbimeve, pasi janë të sigurtë se këta profesionistë janë të pajisur për të adresuar në mënyrë korrekte çështje që lidhen me identitetin e tyre jo-binarë, dhe më tej.

“[CEL] e ka ofrimin, për shembull, psikolog bash që janë që merren me tema t’komunitetit, qajo është, kur e kom pa që ka dikë që merret edhe din me trajtu edhe është, për shembull i verifikum, prej CEL-it për shembull që din me u merr me njerz e komunitetit. E kom pas... Hala mendoj për një herë. Pse mos me shku?” – P.1

Një pjesëmarrës tjetër ndan eksperiencën e tyre pozitive me ofruesit e shërbimeve në listën e CEL.

“[...] po, unë kom marr shërbime, ëë, edhe te CEL-i edhe kom shku te ni psikologe kshtu ekstra, ëëm, para 6 muje muj me thanë qështu diçka edhe e kom fol këtë temë me psikologën, se at’herë jom kanë n’dyshime [që identifikohem si person jo-binarë], nuk është që e kom dit sigurt. Përndryshe psikologia u kanë shumë supportive rreth ksaj çështje edhe m’ka nimu shumë domethan n’aspektin edhe m’ja pranu vetës edhe qët fakt” – P.3

Pjesëmarrës tjetër shpreh se në fushën e marrjes së shërbimeve shëndetsore, të vetmet raste ku nuk ka ndjerë ndonjë nivel të sikletit për shkak të qasjes ndaj tij ka qenë gjatë marrjes së shërbimeve psikiatrike dhe psikologjike përmes listës së përpiluar nga CEL Kosova. Ai përmend se kjo listë është e dobishme pasi largon rrezikun se do të shkosh në seancë me një psikolog që është homofob ose transfob. Kjo u shpreh edhe nga një pjesëmarrës tjetër.

“[...] Qëkjo është diçka tepër e mirë që e kanë bo ... është diçka shumë interesant se t’paktën nuk ki nevojë me bo, like me gjet dikan që nuk osht homofob a transfob ...” – P.2

4. EKZISTENCA E HAPËSIRAVE PËR PERSONA TË KOMUNITETEVE LGBTI+ DHE RËNDËSIA E TYRE

Diçka që pjesëmarrësit cituan si të rëndësishme për mirëqenien e tyre ishte ekzistenca e hapësirave ku personat e komuniteteve LGBTI+ mund të jenë vetvetja. Ata, në fjalët e tyre, shprehën se ekzistenca e hapësirave siç është Bubble Pub në Prishtinë, i kishte bërë të ndihen se ata nuk janë të vetëm, dhe në rastin e një pjesëmarrësit, të kuptojë se ka persona të tjerë në Kosovë që gjithashtu janë pjesë e këtyre komuniteteve.

“Qysh me thanë, e kom pas— qysh me thanë, nifar euforie me ni mnyrë. Që kom pas shkue, edhe [...] i pasha njerzt. T’komunitetit [...]. Edhe e ndijsha diqysh ma qetë, edhe folsha ma lirë.” – P.1

Kjo lidhje gjithashtu me temën e dytë, që ka të bëjë me rrethin social të personave jo-binarë. Në përgjithësi shohim se ekzistenca e hapësirave për të qenë vetvetja dhe personave që janë vetvetja paraqesin aspekt të rëndësishëm të eksperiencave të personave që janë jo-binarë.

5. MUNGESA E MBËSHTETJES INSTITUCIONALE PËR PERSONAT JO-BINARË

Pjesëmarrësit gjithashtu shprehën se vërejnë një mungesë të mbështetjes institucionale për personat që identifikohen si jo-binarë, ose në përgjithësi jashtë binarit të gjinisë. Pjesëmarrësit shprehën se ndjejnë këtë mungesë të mbështetjes, por, në intervistat që kjo temë u diskutua në mënyrë më të fokusuar, u trajtua në dy mënyra të ndryshme. Njëri nga pjesëmarrësit ka folur më ekstensivisht për vështirësitë që personat jashtë konformit të gjinisë kanë për të ndryshuar emrin dhe gjininë e tyre në dokumentet e tyre personale. Ata, këtë, e shprehën kryesisht në kontekst të ndryshimit të gjinisë nga femër në mashkull, apo të kundërtën, por gjithashtu shtuan se vetë mungesa e një opsiioni të tretë në dokumente, për persona jashtë binarit, e bën këtë shumë herë më të vështirë për personat jo-binarë.

Ndërsa pjesëmarrësi tjetër shpreh frustrimin e tij në lidhje me qasjen e figurave politike ndaj çështjeve që përkohet me komunitetet LGBTI+ në Kosovë. Ai ndjen se figurat politike në Kosovë nuk janë të njoftuara mjaftueshëm me këto çështje, dhe nuk e shohin realitetin e situatës për këta persona në Kosovë. Gjithashtu ndan edhe frustrimin me mosklasifikimin e krimeve të urrejtjes në mënyrë të saktë, domethënë si krime të urrejtjes dhe jo vetëm krime, kur bëhet raportimi i tyre në stacionet policore të Kosovës.

“Qysh e di une edhe për raportimin e hate crimes nuk, nuk kategorizohen si hate crimes, I might be wrong on this I don’t know, po yeah nuk kategorizohen si hate crime po veç si krim, big difference, ëëm, it’s different if someone steals my phone and it’s different if someone steals my phone because I’m trans. I’m being targeted for that.” – P.2

Pjesëmarrësi tjetër shpreh dozë pesimizmi për përmirësimin e kësaj qasje ndaj personave që janë jo-binarë në Kosovë, duke thënë se shpresat e tyre janë shumë të ulëta.

Përveç këtyre, nën këtë temë mund të fusim edhe qasjen që pjesëmarrësit raportuan ndaj tyre në institucionet e ndryshme shtetërore në Kosovë, shembull institucionet mjekësore, dhe njësitë si ajo komunale dhe policore. Përderisa njëri nga pjesëmarrësit edhe shprehu se preferojnë të mos ndajnë identitetin e tyre gjinore fare, pasi ndihen të pasigurtë të bëjnë këtë.

6. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E MBËSHTETJES NDAJ PERSONAVE JO-BINARË

Sa i përket rekomandimeve që pjesëmarrësit diskutuan që mund të ndihmojnë në mbështetjen ndaj personave jo-binarë në Kosovë, kjo u diskutua në dy nga intervistat e bëra. Njëri pjesëmarrës shprehu se mënyra të lehta për të mbështetur personat jo-binarë është normalizimi i tualeteve neutrale ndaj gjinisë. Ai gjithashtu shpreh se një mënyrë tjetër për të mbështetur personat LGBTI+ është të mos bëhen supozime, dhe ndarje të panevojshme në gjini.

“po tjetra është për shembull, ëëm, veç mos me assume, qajo i vetmi sen veç mos me assume. Domethan nëse ... e sheh shumë shpesh për shembull napër shkolla [...] nëse janë për shembull krejt qika let's say, thojn hajde qika krejt a pe din ... kur është, kur jon krejt t'përzim hajdi krejt. Munësh me thanë krejt për krejt.” – P.2

Kurse pjesëmarrësi tjetër merr një perspektivë më gjithëpërfshirëse. Ata shprehin se e shohin të nevojshme që popullata e gjerë të informohet për spektrin dhe larmishmërinë e gjinisë dhe identitetit gjinor që nga mosha e hershme. Duke shprehur frustrimin se mënyra se si gjinia shpjegohet në shkolla është tepër e thjeshtë dhe largon jo vetëm personat jo-binarë nga biseda, por edhe variacionet e tjera gjenetike të seksit të një personi. Komenti tjetër, në lidhje me këtë, është që pjesëmarrësi shpreh frustrim për mënyrën që popullata e gjerë flet për personat e LGBTI+.

“Maspari e kanë mënyra që folin për njerz. Qajo është, kisha thonë, numër një. Se kur fol për dikun keq, normal që ka me pas keq. [...] Edhe kur s'din me fol për diçka.... pse me fol kur s'ki informata, qajo është. Kur s'ki informata, ma mirë mos fol, sa me fol.” – P.1

Pra, si rekomandime kryesore që i shohim tek të dy pjesëmarrësit, kemi aspektin e informimit dhe ndryshimit të qasjes në mënyrë që ajo të jetë më gjithëpërfshirëse dhe inkluzive.

Diskutimi

Rezultatet e këtij studimi identifikojnë se personat jo-binarë në Kosovë përballen me tre lloje të ndryshme të pengesave: gjuhësore, institucionale dhe ato për qasje në shërbime psikologjike. Pengesa themelore në këtë kontekst është mungesa e terminologjisë neutrale për gjini në gjuhën shqipe. Siç e tha një pjesëmarrës, “m’dokët që kur foli shqip duhët me ba matematikë n’krye”, kjo sqaron në mënyrë të shkurtë, por konçize, se gjuha shqipe nuk ofron mundësi adekuate për të përshkruar identitetet jo-binare. Kjo mungesë gjuhësore i detyron pjesëmarrësit të krijojnë strategji të reja, të tilla si përdorimi i gjuhës angleze ose preokupimi për të gjetur ose edhe shpikur shprehje adekuate në gjuhë shqipe. Kjo mungesë gjuhësore ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet shoqërore dhe familjare. Pjesëmarrësit theksojnë rëndësinë e një rrethi shoqëror në të cilin kanë besim, duke treguar se pranimi social shpesh vjen nga individë që ata kanë zgjedhur të krijojnë raporte sociale vetë, jo domosdoshmërisht nga shoqëria në përgjithësi. Kjo është në përputhje me gjetjet e Thorne et al. (2023), ku terminologjia shihet si një mjet për ta bërë identitetin të dukshëm.

Një pengesë tjetër është ajo institucionale. Pjesëmarrësit raportojnë mungesë mbështetjeje nga institucionet shtetërore, nga pamundësia për të ndryshuar dokumentet personale në një opsion të tretë, deri te dështimi për të klasifikuar krimet e urrejtjes si të tilla. Kjo është në përputhje me gjetjet e Newman & Peel (2022) dhe Girardi (2021), të cilat tregojnë se mungesa e njohjes ligjore dhe policore ka një ndikim negativ në jetën e personave jo-binarë.

Sa i përket shërbimeve profesionale, pjesëmarrësit theksojnë rëndësinë e listës së terapistëve të përpiluar nga CEL Kosova. Kjo listë shihet si një burim i besueshëm në një sistem ku ofruesit e tjerë të shëndetit mendor mund të jenë homofobikë ose transfobikë. Ky zbulim përkon me studimin e Schuller et al. (2025), të cilat tregojnë se përvojat negative të të tjerëve i dekurajojnë personat jo-binarë të kërkojnë ndihmë.

Së fundmi, pjesëmarrësit theksojnë rëndësinë e hapësirave fizike si Bubble Pub, të cilat ofrojnë një ndjenjë komuniteti dhe sigurie. Kjo tregon se përballë pengesave, personat jo-binarë krijojnë “coping mechanisms” përmes marrëdhënieve të tyre.

Ky hulumtim ofron një pasqyrë të eksperiencave të personave jo-binarë në Kosovë, duke theksuar pengesat gjuhësore, institucionale dhe sociale. Gjetja kryesore e hulumtimit është roli që gjuha shqipe ka në ruajtjen e binarit gjinor, e cila nuk lë hapësirë për identitete të tjera përveç atyre mashkull ose femër. Pjesëmarrësit jo vetëm që përjetojnë mungesë terminologjike për t’u shprehur në mënyrë që përputhet me identitetin e tyre, por ndihen të detyruar të bëjnë kompromis me vetë identitetin e tyre në mënyrë që të kuptohen nga shoqëria. Përtej kësaj, mungesa e mbështetjes institucionale, nga dokumentet personale deri te klasifikimi jo i saktë i krimeve të urrejtjes, dhe numri i kufizuar e psikologëve që konsiderohen të besuar dhe janë të pajisur për të trajtuar persona të komuniteteve LGBTI+, bashkohen të krijojnë një sistem që i lë personat jo-binarë të ndihen të pasigurtë dhe të kërcënuar.

Limitimet

Si limitim të parë të këtij hulumtimi mund të përmendim madhësinë e vogël të mostrës, ku hulumtimi përfshiu vetëm tre pjesëmarrës, të cilët ishin individë jo-binarë në Kosovë. Kjo e bën të pamundur përgjithësimin e gjetjeve për të gjithë individët jo-binarë në Kosovë. Limitimi i dytë i hulumtimit mund të jetë fokusimi në shumë aspekte dhe përvoja njëkohësisht. Ku mund të ndodhë që jo të gjitha aspektet e jetës dhe përvojat e këtyre individëve janë trajtuar thellësisht. Një limitim tjetër mund të konsiderojmë që studimi, në mënyrë qenësore nuk pati mundësi të kontrollojë për ndëërseksionalitetin e identitetit të personave që ishin pjesëmarrës, sidomos në aspektin e orientimit seksual.

Rekomandimet

Rekomandimi i parë lidhet me një nga gjetjet që konsiderojmë si atë që është kryesore nga ky studim, që është ajo në lidhje me mungesën e terminologjisë. Rekomandojmë që në të ardhmen, të bëhen studime që në mënyrë më të fokusuar e hulumtojnë aspektin gjuhësorë, terminologjik, dhe mangësitë në këto fusha për personat që janë jashtë binarit gjinor. Një rekomandim për hulumtimet e ardhshme është të përfshijnë një mostër më të madhe në mënyrë që rezultatet të jenë më inclusive për eksperiencat të ndryshme që personat jo-binarë në Kosovë mund të kenë. Rekomandim tjetër mund të jetë që hulumtimet e ardhshme të fokusohen në një aspekt të jetës dhe të hulumtojnë më shumë për përvojat e individëve jo-binarë në atë aspekt, për shembull jetën sociale, përvojat në shërbimet shëndetësore ose ato psikologjike. Si rekomandim i fundit, rekomandojmë që të bëhen studime të mëtejshme që eksplorojnë eksperiencat e personave që identifikohen me gjini jashtë binarit të gjinisë, dhe gjini që nuk përkon me seksin që ju është përcaktuar në lindje.

Referenca

Bass, M., Gonzalez, L. J., Colip, L., Sharon, N., & Conklin, J. (2018). Rethinking gender: The nonbinary approach. *American Journal of Health-System Pharmacy*, 75(22), 1821-1823.

Clarke, V., & Braun, V. (2017). Thematic analysis. *The Journal of Positive Psychology*, 12(3), 297–298.

Cronin, T. J., Pepping, C. A., & Lyons, A. (2023). Mental health service use and barriers to accessing services in a cohort of transgender, gender diverse, and non-binary adults in Australia. *Sexuality Research and Social Policy*, 22, 150-163.

DeJonckheere, M., & Vaughn, L. M. (2019). Semistructured interviewing in primary care research: a balance of relationship and rigour. *Family Medicine and Community Health*, 7(2).

Dev, S., Monajatipoor, M., Ovalle, A., Subramonian, A., Phillips, J., & Chang, K. W. (2021). Harms of gender exclusivity and challenges in non-binary representation in language technologies. In *Proceedings of the 2021*

Conference on Empirical Methods in Natural Language Processing (pp. 1968-1994).

Dray, K. K., Smith, V. R. E., Kostecki, T. P., Sabat, I. E., & Thomson, C. R. (2020). Moving beyond the gender binary: Examining workplace perceptions of nonbinary and transgender employees. *Gender, Work & Organization*, 27(6), 1181-1191.

Girardi, R. (2021). 'It's easy to mistrust police when they keep on killing us': A queer exploration of police violence and LGBTQ+ Victimization. *Journal of Gender Studies*, 31(7), 852–862.

Liszewski, W., Peebles, J. K., Yeung, H., & Arron, S. (2018). Persons of nonbinary gender—awareness, visibility, and health disparities. *The New England journal of medicine*, 379(25), 2391.

Lykens, J. E., LeBlanc, A. J., & Bockting, W. O. (2018). Healthcare experiences among young adults who identify as genderqueer or nonbinary. *LGBT health*, 5(3), 191-196.

Maji, S., Yadav, N., & Gupta, P. (2024). LGBTQ+ in workplace: a systematic review and reconsideration. *Equality, Diversity and Inclusion: An International Journal*, 43(2), 313-360.

Newman, H. J. H., & Peel, E. (2022). 'An impossible dream'? Non-binary people's perceptions of legal gender status and reform in the UK. *Psychology and Sexuality*, 13(5), 1381–1395.

Quintana, G. R., & Pfaus, J. G. (2024). Do sex and gender have separate identities?. *Archives of Sexual Behavior*, 53(8), 2957-2975.

Rrasaj, K. (2025). Taking legal progress for LGBTI+ rights in Kosovo: Developments, obstacles and the way ahead. *CEL Kosova*.

Schuller, K. A., Crawford, R. P., & Wolf, M. (2023). Predictors of mental health service utilization among transgender and gender nonconforming adults. *Transgender Health*, 10(1), 73–83.

Thorne, N., Aldridge, Z., Yip, A. K., Bouman, W. P., Marshall, E., & Arcelus, J. (2023). 'I didn't have the language Then'—A Qualitative examination of Terminology in the Development of Non-Binary Identities. *Healthcare*, 11(7), 960.

